



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe neni 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.12.2018, merr këtë

**VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZAT E FSHATIT BUSI**

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Busi.
- II. Lokacioni nga pika I e këtij vendimi, caktohet në fshatin Busi, komuna e Prishtinës, pjesën e parcelës kadastrale nr. 2710-0, Zona kadastrale Busi, "Pasuri Shoqërore - Kuvendi Komunal Prishtinë", në sipërfaqe prej 14179 m².
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të këtij vendimi.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorja e Financave dhe Drejtorja e Kadastrit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-291310/18, më 11.12.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Arsyetim

Në bazë të kërkesës nr. 13-353/01-0183738/18, dt. 27.07.2018, kryetari i Bashkësisë Lokale Mramor - Prishtinë, ka kërkuar nga Drejtoria e Pronës caktim të lokacionit të pronës komunale për varreza në fshatin Busi. Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, pas pranimit të e-mailit zyrtar nga Drejtoria e Pronës, më 01.10.2018, dhe shqyrtimit të të njëjtës e pajis këtë drejtori me informim nga plani rregullues, sipas së cilës parcela nr. 2710-0, ZK Busi, shtrihet brenda Planit zhvillimor komunal. Në bazë të këtij plani, kjo parcelë gjendet jashtë zonave të planifikuara për ndërtim, mirëpo në raste specifike, mund të ndërtohen objekte bujqësore dhe blegtorale edhe më thellë në zonat rurale (jashtë zonave të shënuara), me një trajtim të veçantë nga sektorët përkatëse të Komunës së Prishtinës (Sektori për mjedis, Departamenti për ekonomi etj.).

Drejtorja e Pronës e ka shqyrtuar kërkesën e lartcekur, për caktim të lokacionit, pjesës së parcelës kadastrale nr. 2710-0, ZK Busi, me sipërfaqe prej 14179 m², të evidentuar në certifikatën e pronës P-71914008-02710-0, pasuri shoqërore - shfrytëzues KK Prishtinë.

Qëllimi për caktim të lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, sipas këtij propozimi, është që kjo parcelë të shfrytëzohet për zgjerimin e varrezave, pasi që tash për tash është duke u shfrytëzuar për varreza në fshatin Busi, komuna e Prishtinës.

Bashkësia Lokale në Mramor ka ushtruar kërkesë me nr. 13-353/01-0183738/18, dt. 27.07.2018, në Drejtorinë e Pronës për caktim të lokacionit të pronës komunale për varreza të fshatit në Busi - Prishtinë.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore si në pjesën hyrëse të këtij propozimi, kërkesës nr. 13-353/01-0183738/18, dt. 27.07.2018, nga Bashkësia Lokale Mramor dhe në shkresat e lëndës, u vendos si në dispozitiv të këtij propozimi.